



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
BASHKIA POGRADEC  
KRYETARI

Nr. 1631/11 prot.

Pogradec, më 17.04.2025

**Lënda:** Dërgohet material për shqyrtim e miratim.

**Znj. Manjola KAMOLLI**  
**KRYETAR I KËSHILLIT BASHKIAK**

**E nderuar zonja Kryetare,**  
Bashkëngjitur po ju dërgojmë projekt vendimin, dhe relacionin shoqërues, për: **“MIRATIMIN E  
TARIFËS SË SHËRBIMIT TË UJITJES SË TOKAVE BUJQËSORE”**

Me respekt,

**KRYETAR**

**Ilir XHAKOLLI**



Nr. i faqeve A4 të projekt-vendimit: 1

Nr. i faqeve A4 të relacionit shoqërues: 5



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
BASHKIA POGRADEC  
KËSHILLI**

Nr. \_\_\_\_\_ Prot.

Pogradec, më \_\_\_\_\_.\_\_\_\_.2025

**PROJEKT – VENDIM  
NR. \_\_\_\_\_, DATË \_\_\_\_\_.\_\_\_\_.2025**

**PËR  
MIRATIMIN E TARIFËS SË SHËRBIMIT TË UJITJES SË TOKAVE  
BUJQËSORE.**

Në mbështetje të nenit 8, pika 2, neni 9, pika 1.1, neni 23, pika 14, neni 27, pika 1, neni 54 dhe neni 55 të Ligjit Nr. 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, neni 15, neni 17 dhe neni 18 dhe kreu IV të ligjit nr. 24/2017 “Për administrimin e ujitjes dhe kullimit”, VKM-në nr. 1108, datë 30.12.2015, të Këshillit të Ministrave, “Për transferimin, nga Ministria e Bujqësisë, Zhvillimit Rural dhe Administrimit të Ujërave të bashkitë, të infrastrukturës së ujitjes dhe kullimit, të personelit dhe të aseteve të luajtshme e të paluajtshme të bordeve rajonale të kullimit”, Këshilli i Bashkisë

**VENDOSI :**

1. Të miratojë tarifën për ujitjen për fermerët në masën 300 lekë/1000 m<sup>2</sup> me rrjedhje të lirë dhe 200 lekë /1000 m<sup>2</sup> me ngritje mekanike. (tarifë kjo e cila ngelet e pa ndryshuar nga vitet e mëparshme ).
2. Kjo tarifë do të vilet nga ana e Ndërmarrjes së Mirëmbatjes së Infrastrukturave dhe Punëve Publike në momentin e furnizimet me ujë të fermerëve.
3. Tarifa është e vlefshme deri në realizimin e analizës për shërbimin dhe miratimin e tarifave të reja.
4. Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohet Kryetari i Bashkisë dhe Ndërmarrja e Mirëmbatjes së Infrastrukturave dhe Punëve Publike.
5. Vendimi hyn në fuqi 10 ditë nga data e shpalljes.

**KRYETAR  
MANJOLA KAMOLLI**



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË**  
**BASHKIA POGRADEC**  
**NDËRMARRJA E MIRËMBAJTJES SË INFRASTRUKTURAVE DHE PUNËVE PUBLIKE**  
**SEKTORI UJITJE KULLIM**

**RELACION MBI SITUATËN E SISTEMIT TË VADITJES DHE KULLIMIT PËR**  
**TOKAT BUJQËSORE.**

**Drejtuar :** **KRYETARIT TË BASHKISË POGRADEC**

**KËSHILLIT TË BASHKISË POGRADEC**

**(Këtu)**

**I nderuar z. Kryetar!**  
**Të nderuar anëtarë të Këshillit!**

**Situata aktuale dhe parashikimet ligjore.**

Në zbatim të dispozitave ligjore dhe konkretisht nenit 15, të ligjit nr. 24/2017, “Për administrimin e ujitjes dhe kullimit”, bashkia është përgjegjëse për shfrytëzimin dhe administrimin e infrastrukturës ujitëse dhe të kullimit në tokat bujqësore. Modalitetet se si i shfrytëzon, ky ligj dhe aktet nënligjore parashikojnë që i ushtron si cdo shërbim tjetër që kryen bashkia, nëpërmjet ushtrimit të këtij funksioni dhe shërbimi vetë, me strukturat e saj ose nëpërmjet organizatave të ujitjes të cilat funksionojnë me anëtarësinë e vetë fermerëve në formën e organizimit juridik si OJF (neni 20 e në vijim i ligjit të mësipërm).

Sigurisht që për kryerjen e shërbimit, si në cdo rast tjetër ligji parashikon edhe vaplikimin e tarifave përkatëse me parimin mbulimit të kostove të shërbimit nga tarifat. (Tarifa vjetore e mirëmbajtjes dhe tarifa e shërbimit për sasinë e ujit të përdorur sipas përcaktimeve të nenit 17 dhe 18 të ligjit.). Momentalisht, shërbimi është kryer nga organizatat e fermerëve në zonat e shërbimit, duke menaxhuar sasinë e ujit në rezervuarë dhe duke palikuar vetëm një tarifë për sasinë e ujit të përdorur. Situata në këtë sektor realisht ka erdhur duke u përkeqësuar dhe ky shqetësim është shprehur vazhdimisht nga fermerët dhe momentalisht kërkesat dhe ankesat e fermerëve paraqesin një situatë shumë kritike pasi këto organizata nuk po mundën të menaxhojnë shërbimin e furnizimet me ujë për vaditje, duke pasur pakënaqësira edhe për cëshjen e tarifave të cilat nuk kanë transparencë por edhe ka sjellë dëmtime të sistemit të ujitjes dhe kullimit deri në atë fazë sa tashmë



e kemi të pamundur të menaxhojmë kërkesat në rritje të infrastrukturës së vaditjes me investime për ta pasur atë në gjëndje optimale.

Theksojmë se pavarësisht se sistemet menaxhoheshin nga organizatat e ujitjes së fermerëve, nga ana jonë janë kryer vazhdimisht ndërhyrje në mirëmbajtje dhe investime të infrastrukturës së vaditjes me fonde të transferuara por edhe me fonde të bashkisë.

Sot nga një vlerësim paraprak edhe për shkak të pakësimit të burimeve ujore të cilat furnizojnë sistemin e vaditjes, por sidomos nga keqmenaxhimi i sasive të ujit që ndodhen në rezervuarë, rezulton që një pjesë e mirë e ujit të rezervuarve keqpërdoret duke mos hskuar atje ku janë nevojat. Edhe fermerët e shprehin këtë shqetësim, duke theksuar se nëse do ketë mirëmenaxhim të sasive të gruambulluara do ishin të mjaftueshme për të vaditur tokat bujqësore të cilat janë të pajisura me system vaditjeje.

Në këtë situatë, duke konsideruar edhe faktin se pavarësisht se organizatave ju është lënë një kohë e konsiderueshme për tu formalizuar dhe për të vepruar sipas parashikimeve ligjore (regjistrimi në gjykatë, miratimi i statuteve dhe akteve të themelimit, funksionimi i bordeve dhe miratimi i tarifave, auditim të shpenzimeve nga Bashkia etj, të gjithë dispozita të përcaktuara nga ligji i mësipërm nenet 21, 26, 27, 28-37, 38, 42, 43, 46), ato sot funksionojnë përsëri të paformalizuara dhe është e pamundur kontrolli i kryerjes së shërbimit si dhe duke konsideruar faktin se jemi në një situatë emergjente përpara sezonit të vaditjes massive të bimëve, kërkojmë që Bashkia të marrë funksionin e plotë të mirëmbajtjes dhe shfrytëzimit të sistemeve të vaditjes dhe kullimit për ta kthyer atë në standartet ligjore dhe për të shmangur mungesën e ujit në tokat bujqësore të fermerëve.

Ky fakt është konsultuar me fermerët, të cilët e kanë kërkuar vetë realizimin e shërbimit dhe njëkohësisht me kryeleqtë e fshatrave të cilat kanë në funksion system vaditës.

Më poshtë po ju propozojmë modalitetet e kryerjes së këtij shërbimi nga ana e Ndërmarrjes tonë.

## **Realizimi i funksionit dhe fazat e realizimit:**

Në Bashkinë Pogradec sipas pasaportave të digave janë vlerësuar 13 ujëmbledhësa me diga të mëdha. Sezoni i ujitjes është një nga sezonet më të rendësishme për fermerët, për kulturat bujqësore të cilat ata kultivojnë. Por menaxhimi i sezonit të ujitjes në Bashkinë tonë mormalisht nga sa shpjeguar më sipër, janë evidentuar një sërë problematikash të cilat do të mundohemi ti shmangim nëpërmjet menaxhimit të studiuar të situatës.

Ndërkohë, konsiderojmë se një studim i mirëfilltë në lidhje me kostot e shërbimit, sipërfaqet që mund të mbulohen, rekomandimet për shtrirjen e zonës së shërbimit edhe në toka të cilat nuk janë shërbyer deri më tani, si dhe vlerësim të tarifave sipas përcaktimeve të nenit 17 dhe 18 të ligjit nr. 24/2017, "Për administrimin e ujitjes dhe të Kullimit", kërkon një kohë prej 3-6 muaj, pasi ka nevojë për kapacitete në burime njerëzore të dhëna etj. Për të mos lënë shërbimin në situatë të vështirë propozojmë implemtimin e realizimit të shërbimit në 2 faza:

### **Faza I. Realizimi në kushtë emergjente i shërbimit. Afati 3-6 muaj**

Në këtë fazë e cila propozojmë të kryejmë shërbimin në kushtë emergjence për shkak se edhe sezoni i ujitjes është në prag dhe rrezikohen prodhimet bujqësore të fermerëve në zonat e shërbimit. **Propozojmë që në këtë fazë të mbajmë të paktën standartin e vitit të kaluar, duke angazhuar burimet njerëzore të cilat kanë qënë dhe janë edhe sot në funksion por thjesht duke kaluar varësinë nga ish organizatat e ujitjes (të cilat nuk kanë qënë funksionale dhe të formalizuara**



si shpjeguar më sipër). Duke angazhuar të njëjtat burime njerëzore dhe infrastrukturë e cila është sot në terren, mendojmë se nëpërmjet një menaxhimi më të mirë dhe llogaridhënie në Ndërmarrjen tonë dhe më pas në Bashki, të bëjmë të mundur që me këtë infrastrukturë që është gjëndje dhe me këtë sasi uji që ndodhet në basenet ujore të rrisim cilësinë e shërbimit, duke cuar ujë pikërisht atje ku është nevojë dhe duke siguruar një trajtim të barabartë për të gjithë fermerët. Në mënyrë që kjo të realizohet sa më mirë do marrim masat si më poshtë:

- Do ngrejmë regjistrin e gjëndjes së ujit në basene të cilat do të monitorohen, raportohen dhe bëhen publike për gjithë fermeret periodikisht.
- Të mbajmë regjistrin e shpërndarjes së ujit sipas parcelave të fermerëve dhe analizuar diferencat me gjëndjen e ujit në basenet ujore. Rregjistri të bëhet publik ndaj gjithë fermerëve.
- Të hyjë në funksionim sistemi i faturimit të fermerëve për cdo pagesë që do bëjnë për vaditje, duke rakorduar sasinë e lekëve të grumbulluara nga tarifa me regjistrin e ujit të shpërndarë.
- Punonjësit aktualë, të cilët do të kalojnë në varësi të Ndërmarrjes, të angazhohen në mirëmbajtjes e zakonshme të kanaleve të vaditjes dhe kullues gjatë kohës që nuk ka shërbim vaditjeje duke krijuar efikasitet dhe mirëmenaxhim të burimeve njerëzore.
- Të evidentohen dhe raportohen të gjithë problemet e infrastrukturës së ujit dhe kullimit (dëmtime në kanale, nevojë për investime etj) për ti shërbyer fazës së analizimit të kostove dhe nevojave të shërbimit.

Gjatë kësaj faze propozojmë aplikimin e tarifave që aplikojnë sot organizatat në mënyrë që fermerët mos kenë shqetësime në këtë situatë emergjente. **Për këtë qëllim i kërkojmë Këshillit Bashkiak që për këtë fazë pregatitore të miratojë këto tarifa sipas Vendimit të propozuar. Këto tarifa do të jenë në fuqi dhe do aplikohen gjatë fazës së parë 3-6 mujore deri në realizimin e studimit mbi kostot e shërbimit dhe studimit të mundësive financiare që ka insitucioni për të mbuluar këto kosto.**

#### **Faza I.I faza e realizimit të studimit të kostove dhe nevojave (afati 3-6 muaj)**

Kjo fazë do të realizohet paralelisht me [Faza I. Realizimi në kushtë emergjente i shërbimit. Afati 3-6 muaj](#). Pra gjatë kohës që do të vijohet me kryerjen e shërbimit në kushte emergjente nga ana e Kryetarit të Bashkisë do të ngrihet grupi i punës i cili do të realizojë një analizë të plortë të disa aspekteve:

- Kostot e shërbimit duke përfshirë:
  - o Kostot operative.
  - o Kostot e mirëmbajtjes.
  - o Kostot e investimeve
  - o Kosto të tjera.
- Nevojat për investime në infrastrukturën ekzistuese të vaditjes por edhe të kullimit.
- Vlerësimin e sipërfaqeve të cilat mbulohen nga zonat e shërbimit.
- Nevojat për ujë sipas kulturave bujqësore dhe periudhat e ujitjes.
- Sasitë e disponueshme të ujit në basenet ujore.
- Standartet teknike të matshme për shërbimin me faza. (Zonat e mbuluara me shërbim, sasinë e ujit tqë duhet të furnizohet, skenarët e funksionimit të shërbimit, rekomandime dhe analizim me kosto për përmirësimin e standarteve dhe shtrirjen e zonës së shërbimit etj).
- Vlerësimi paraprak i tarifimit në 2 lloje tarifash (tarifa mirëmbajtjeje dhe tarifa shërbimi sipas përcaktimeve të neneve 17 dhe 18 të ligjit.
- Aspekte të tjera të vlerësuara nga specialitet, pjesë e grupit të punës.

Grupi i punës mendohet se ka të nevojshme një periudhë prej maksimalisht 6 muajsh pasi volume i punës është i konsdierueshëm dhe kërkon të dhëna të reja dhe shërbimi nuk është vlerësuar asnjëherë.

Në grupin e punës propozohen të jenë pjesë:



- Ekspert topografë.
- Ekspertë agronomë.
- Inxhinier hidroteknik.
- Inxhinier mjedisi
- Ekonomist
- Jurist
- Specialistë nga NMI përgjegjës për sistemin e ujitjes dhe kullimit.

Konkluzionet dhe rekomandimet e pasqyruara në relacion nga grupi i punës do ti paraqiten Kryetarit të bashkisë i cili me stafin menaxherial do të vlerësojë mundësitë financiare mbi mbulimin e kostove dhe do të paraqesë në Këshill materialin përkatës për miratimin e tarifave të reja.

### **Faza II. Realizimi i shërbimit me standarte dhe konform dispozitave ligjore. Afati 6 muaj pas implementimit e në vijim.**

Në këtë fazë pas dakortësimit edhe nga ana e Këshillit të tarifave dhe standarteve që do të konkludojnë dhe propozojnë grupi i punës, pas vlerësimit që do të bëhet edhe nga ana e Kryetarit të Bashkisë edhe Këshillit mbi masën e mbulimit të kostove të shërbimit nëpërmjet tarifave të reja që do të miratohen dhe aplikohen Ndërmarrja do të vijojë punën nëpërmjet punonjësve të saj duke ju përmbajtur kriterëve dhe standarteve që do të miratojë Këshilli për kryerjen e shërbimit në afatet dhe fazat që do ti vendosen si objektiv.

Në këtë fazë këshilli duhet të analizojë periodikisht shërbimin duke ndryshuar standartet, fazat e aplikimit të tarifave të diferencuara apo sipas fashave kohore që do ti vendosë vetë.

### **Aspektet e tarifimit dhe kostove.**

Ashtu si përmendëm më sipër, si cdo shërbim tjetër që kryen sot Bashkia (pastrami, gjelbërimi, ndricimi etj.) edhe ky shërbim ka si parim ligjor mbulimin e kostove të shërbimit nëpërmjet tarifave. Për këtë qëllim ligji ka parashikuar për këtë shërbim 2 kategori tarifash që duhen paguar nga fermerët:

- Neni 17 përcakton tarifën e mirëmbajtjes, e cila është tarifë vjetore dhe duhet të mbulojë totalin e kostove që ka Bashkia për mirëmbajtjet periodike të infrastrukturës (pastrime, riparime, riveshje të kanaleve, kosto operative etj.). kjo tarifë është vjetore dhe paguhet nga të gjithë fermerët pavarësisht faktit se sa sasi uji kanë nevojë për vaditje. Në këtë vlerësim sigurisht që mund të përcaktohen metodika të ndryshme në varësi të vlerësimit që mund të bëjnë ekspertët dhe në varësi të politikbërjes së Këshillit.
- Neni 18 përcakton tarifën e shërbimit e cila paguhet mbi sasinë e ujit që përdor cdo fermer dhe paguhet në momentin e ujitjes. Kjo ka të bëjë me koston që ka Bashkia për të furnizuar me ujë tyë cilat mund të jenë, kosto për energji elektrike për ngritjen e ujit ose hapjen mbylljen e ujit, kosto për pagesën e tarifave të ujit të përdorur në ministrinë e Financave dhe Autoritetin e Basenit ujor etj).

Nga ana tjetër, duke analizuar vlerën totale të kostove për shërbimin, duke përfshirë kostot e mirëmbajtjes, kostot operative, kostot e investimeve mendojmë se vlerësimi paraprak do të rezultojë më një vlerë shërbimi të konsiderueshme. Në këtë kuptim edhe tarifimi i fermerëve nëpërmjet 2 tarifave të mësipërme natyrisht që nuk mundet të pretendohet se do të mbulojë 100% koston. Për më tepër nëse do kërkohet shtrirja e zonës së shërbimit dhe rritja e standarteve të shërbimit, kostot do jenë shumë herë më të larta. Për këtë arsye analiza që do të realizojë grupi i ekspertëve duhet të parashikojë të gjithë kostot, përfshirë edhe skenarët e shtrirjes së zonës së

shërbimit dhe rritjen e standarteve (duke siguruar më shumë ujë për fermerët) por tarifimi duhet të vijë gradual në rritje, në periudha disavjecare dhe në përputhje me politikbërjen e Bashkisë dhe nuk mund të pretendojmë që për një periudhë afatshkurtër të kemi mbulim të kostove nga tarifat. Shërbimi do të vijojë të subvencionohet në vijim nga bashkia ose nga burime alternative dhe vetëm pas përmirësimit të shërbimit he rritjes së prodhimeve bujqësore mund të kërkohet rritje graduale e tarifave. Kjo është zbatuar për shumë vite edhe me shërbimet e tjera. Ky projekt- vendim është një akt administrativ me karakter normativ.

Duke konsideruar një sfidë realizimin për herë të parë të këtij shërbimi në mënyrë të plotë nga ana jonë, ju kërkojmë bashkëpunimin dhe mirëkuptimin tuaj.

Mirëpresim cdo sygjerim në vijim për përmirësimin e shërbimit.

**Ju Faleminderit!**

**KRYETAR**

**ILIR XHAKOLLI**

